

RAPORT I EKSPEDITËS GJURMUESE NË ZONËN E ÇAMËRISË

Projekti Kërkimor: “Vendbanimet dhe Banesat fshatare në Shqipërinë jugore”

1. Të dhëna të përgjithshme mbi projektin

Projekti kërkimor “Vendbanimet dhe banesat fshatare në Shqipërinë Jugore”, me drejtues shkencor Prof. Pirro Thomo, realizohet në bashkëpunim ndër-institucional ndërmjet Akademisë dhe AKKSHI-së. Projekti synon studimin sistematik të tipologjive të vendbanimeve dhe banesave fshatare, analizën e vlerave arkitektonike, ndërtimore dhe historike të tyre, si dhe evidentimin e gjendjes aktuale të monumenteve të kulturës në zonat përkatëse studimore.

Në kuadër të projektit, kërkimi realizohet përmes disa grupeve kërkimore të përbëra nga universitete të ndryshme, të cilat janë përqendruar në zona të caktuara gjeografike të Shqipërisë Jugore.

2. Përbërja e Grupit dhe zona e studimit

Grupi kërkimor i Universitetit “Barleti”, në këtë ekspeditë ta parë, është përqendruar në zonën e Çamërisë, me fokus të veçantë qytetin e Konispolit, në të cilin është përqendruar një numër i konsiderueshëm banesash të shpalluar monument kulture.

Ekspedita e parë gjurmuese u zhvillua në zbatim të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, e ndryshuar dhe autorizimit nr. 1705/3, datë 21.11.2025. Në këtë ekspeditë mori pjesë personeli shkencor: Prof. Asoc. Dr. Saimir Kristo, Ark. Klesta Qirici, Ark. Andi Papastefani. Ekspedita ka përfshirë edhe zonën e fshatrave Shalës dhe Vagalat.

3. Qëllimi dhe Objektivat e Ekspeditës

Qëllimi kryesor i ekspeditës së parë gjurmuese ishte realizimi i një vlerësimi të drejtpërdrejtë në terren të monumenteve të kulturës që përfaqësojnë banesat dhe objektet me vlera arkitektonike në zonën e Çamërisë, si pjesë integrale e trashëgimisë ndërtimore fshatare të Shqipërisë Jugore. Ekspedita synoi identifikimin e këtyre pasurive, vlerësimin paraprak të gjendjes së tyre fizike dhe arkitektonike, si dhe dokumentimin e situatës aktuale të ruajtjes, në funksion të objektivave të përgjithshme të projektit kërkimor.

Në këtë kuadër, një objektiv thelbësor i ekspeditës ishte verifikimi në terren i pasurive të shpallura monument kulture, duke u mbështetur në kartelat zyrtare të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe artikujt shkencor të cilët kanë dokumentuar këto pasuri ndër vite. Krahasimi

ndërmjet të dhënave arkivore dhe gjendjes reale të objekteve mundësoi evidentimin e ndryshimeve të ndodhura ndër vite, si në aspektin ndërtimor ashtu edhe në atë funksional.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua dokumentimit fotografik të objekteve, i cili shërben si material bazë për analizat e mëtejshme tipologjike dhe krahasuese. Dokumentimi u përqendrua në evidentimin e volumetrisë, elementeve konstruktive, trajtimit të fasadave dhe marrëdhënies së objekteve me kontekstin përreth. Gjithashtu, gjatë ekspeditës u identifikuan problematikat kryesore që lidhen me ruajtjen e monumenteve, përfshirë dëmtimet strukturore, mungesën e mirëmbajtjes, braktisjen funksionale dhe ndërhyrjet e mundshme të papërshtatshme. Këto vëzhgime përbëjnë një bazë të rëndësishme për vlerësimin e rrezikut dhe për hartimin e rekomandimeve në fazat e ardhshme të projektit.

Në përfundim, ekspedita shërbeu si një fazë eksploruese, duke siguruar të dhëna paraprake thelbësore për zhvillimin e analizave të mëtejshme shkencore, në funksion të studimit tipologjik, historik dhe arkitektonik të banesave tradicionale të Shqipërisë Jugore.

4. Metodologjia e punës

Metodologjia e ndjekur gjatë ekspeditës gjurmuese u ndërtua mbi një kombinim të kërkimit paraprak dokumentar dhe verifikimit të drejtpërdrejtë në terren, në përputhje me objektivat e projektit kërkimor.

Në fazën përgatitore u realizua konsultimi i kartelave të pasurive të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, të cilat shërbyen si bazë referuese për identifikimin e objekteve monument kulture dhe për orientimin e punës në terren.

Në vijim, ekspedita u përqendrua në identifikimin fizik të objekteve sipas të dhënave arkivore, duke verifikuar përputhshmërinë ndërmjet informacionit arkivor dhe situatës reale. Ky proces u shoqërua me inspektimin vizual të gjendjes ndërtimore dhe arkitektonike të monumenteve, me qëllim evidentimin e tipareve morfologjike, elementeve konstruktive dhe ndërhyrjeve të mundshme të mëvonshme.


Një komponent thelbësor i metodologjisë ishte dokumentimi fotografik sistematik, i cili përfshiu fasadat kryesore, elementet ndërtimore karakteristike dhe ambientin përreth të objekteve. Aty ku ishte e mundur u ariit të bëhej një inspektim vizual edhe në ambjentet e brëndshme të këtyre monumenteve. Ky dokumentim shërben si material fillestar për analizat e mëtejshme tipologjike, krahasuese dhe historike, si dhe për vlerësimin e gjendjes së ruajtjes së monumenteve.

Paralelisht me dokumentimin vizual, u regjistruan vëzhgime të detajuara mbi gjendjen e konservimit dhe përdorimin aktual të objekteve, duke evidentuar problematikat kryesore që lidhen me mirëmbajtjen, funksionin dhe integritetin arkitektonik të tyre.

Në tërësi, kjo fazë e kërkimit ka karakter eksplorues dhe përbën bazën metodologjike mbi të cilën do të zhvillohen analizat tipologjike dhe historike të fazave pasuese të projektit.

5. Monumentet e identifikuara dhe të dokumentuara

A. BANESA (PASURI SHTETI) E DINO OMERIT NË KONISPOL





Banesa, e ndërtuar në fund të shekullit XIX në kurrizin e kodrës së Buarit, paraqet aktualisht një gjendje të avancuar degradimi, e cila lidhet drejtpërdrejt me mungesën e ndërhyrjeve restauruese dhe braktisjen funksionale pas vitit 2006, kur është rrëzuar çatia e objektit. Struktura volumetrike e banesës, me formë paralelopipedi dhe zhvillim në tre kate, mbetet ende e lexueshme, por integriteti ndërtimor dhe arkitektonik është rëndë i komprometuar.

Muret mbajtëse të banesës, të ndërtuara me muraturë guri të lidhur me llaç gëlqeror, paraqesin dëmtime të shumta strukturore. Në zona të ndryshme vërehen shembje të pjesshme të murit, humbje të materialit lidhës dhe zhveshje të theksuar të strukturës së gurit. Qoshet e banesës dhe kornizat e dyer-dritareve, të realizuara me gurë të gdhendur, megjithëse më rezistente, shfaqin çarje, zhvendosje dhe konsumim të sipërfaqes, duke dëshmuar për dobësim të stabilitetit statik.

Në disa segmente, veçanërisht në katet e sipërme, mungesa e mbështetjes horizontale pas rrëzimit të çatisë dhe ndërkateve, ka shkaktuar deformime dhe shembje të mëtejshme të muraturës, duke e bërë strukturën të rrezikuar nga degradimi progresiv.

Çatia e banesës është e rrëzuar pothuajse tërësisht, duke ekspozuar hapësirat e brendshme ndaj kushteve atmosferike. Humbja e mbulesës ka sjellë degradim të përshpejtuar të dysHEMEVE, trarëve të drurit dhe ndarjeve të brendshme. Elementet mbajtëse të çatisë janë pothuajse të zhdukura ose të dëmtuara rëndë, ndërsa gjurmët e tjegullave të rëna janë të dukshme në ambientet e brendshme dhe përreth objektit.

Dyshemetë ndërmjet kateve, të mbështetura në konstruksion druri, janë në pjesën më të madhe të shembura ose të amortizuara, duke ndërprerë lidhjen funksionale dhe strukturore ndërmjet niveleve.

Ambjentet e banimit në katin e dytë dhe të tretë, të organizuara në oda të njëpasnjëshme të lidhura me një korridor të gjatë, janë sot tërësisht të hapura dhe të ekspozuara. Oxhaqet individuale të çdo ode, ndonëse të identifikueshme në formë dhe pozicion, paraqesin dëmtime të konsiderueshme, me shembje të pjesëve të sipërme dhe humbje të suvasë apo elementeve ndërtimore përreth.

Kati i parë, i shtruar fillimisht me pllaka guri, ruan vetëm fragmente të dysHEMESË origjinale. Pjesa më e madhe e shtrimit është dëmtuar ose mbuluar nga materiale të rrënuara, çka e bën të vështirë leximin e plotë të organizimit funksional fillestar.

Territori i jashtëm i banesës, i rrethuar me avlli guri të lartë, paraqet gjithashtu një gjendje të avancuar amortizimi. Muret rrethuese kanë pësuar shembje të pjesshme, ndërsa dy portat me qemer, megjithëse ende të identifikueshme në volum dhe formë, shfaqin çarje strukturore dhe humbje të materialit ndërtimor.

Qemerët, si elementë karakteristikë të arkitekturës tradicionale, janë të dëmtuar në zonat e kyçjes me muraturën përreth, duke rrezikuar stabilitetin e tyre afatgjatë.

Në tërësi, banesa rezulton të jetë e amortizuar në rreth 85% të volumit dhe elementeve të saj ndërtimore. Megjithatë, pavarësisht nivelit të lartë të degradimit, struktura bazë e objektit, tipologjia arkitekturore dhe organizimi hapësinor mbeten të lexueshme dhe përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni. *Gjendja aktuale e objektit kërkon ndërhyrje urgjente konservuese për të ndaluar degradimin e mëtejshëm dhe për të garantuar ruajtjen e vlerave historike dhe arkitektonike të kësaj banese monument kulture.*

B. BANESA SHETETËRORE (ISH-SPITALI I QYTETIT)

Banesa Shtetërore (ish-spitali i qytetit), e datuar në shekullin XIX dhe e shpallur Monument Kulture i Kategorisë I, Nr. 266/1. Datë . 16.02.1979, paraqet aktualisht një gjendje ruajtjeje të përgjithshme të qëndrueshme, megjithëse me problematika të dukshme degradimi të disa elementeve ndërtimore dhe arkitektonike, të lidhura kryesisht me amortizimin natyror, ekspozimin ndaj faktorëve atmosferikë dhe ndërhyrjet e kufizuara mirëmbajtëse.





Muret mbajtëse të objektit janë të ndërtuara me muraturë guri të lidhur me llaç gëlqeror dhe ruajnë në pjesën më të madhe integritetin strukturor. Megjithatë, në sipërfaqet e jashtme vërehet degradim i shtresës së suvasë, humbje e materialit lidhës dhe ekspozim lokal i gurëve, veçanërisht në zonat e ekspozuara ndaj lagështisë dhe rrjedhjeve sipërfaqësore.

Në disa segmente të fasadës evidentohen njolla të errëta biologjike, shenja lagështie kapilare dhe mikroçarje sipërfaqësore, të cilat nuk duken të rrezikojnë menjëherë stabilitetin, por kërkojnë monitorim dhe ndërhyrje konservuese parandaluese.

Qoshet e ndërtesës dhe kornizat e dyer-dritareve, të realizuara me gurë të gdhendur, paraqiten në gjendje relativisht të mirë strukturore, megjithëse me shenja konsumimi të sipërfaqes dhe erozioni të lehtë.

Çatia e objektit kryesor, e mbuluar me tjegulla, ruan formën dhe funksionin e saj mbrojtës në pjesën më të madhe të volumnit. Megjithatë, në disa zona vërehen zhvendosje të pjesshme të tjegullave dhe amortizim i elementeve mbajtëse, çka favorizon infiltrimin e ujërave atmosferike.

Në objektin ndihmës (zapanaja), veçanërisht në pjesën e magjesisë në anën juglindore, mbulesa e çatisë rezulton e rrëzuar plotësisht, duke ekspozuar ambientet e brendshme dhe duke përshpejtuar degradimin e konstruksionit horizontal.

Dyshemeja e katit përdhe, e shtruar me pllaka guri, ruan karakterin origjinal dhe paraqitet përgjithësisht e qëndrueshme, megjithëse me konsumim të sipërfaqes dhe deformime lokale. DysHEMEJA e katit të sipërm, e realizuar me konstruksion druri dhe dërrasa, paraqet shenja amortizimi, por mbetet funksionale.

Tavanet prej druri të punuar ruhen në gjendje të mirë strukturore, me dëmtime kryesisht sipërfaqësore dhe të lokalizuara, të lidhura me lagështinë dhe plakjen e materialit.

Porta kryesore e hyrjes, me përmasa të konsiderueshme dhe e kornizuar me gurë gëlqerorë të punuar, ruan formën dhe funksionin e saj, duke përbërë një element të rëndësishëm për leximin tipologjik të objektit. Qemerët mbi hapjet janë të qëndrueshëm strukturalisht, megjithëse në disa raste paraqesin mikroçarje dhe humbje të pjesshme të suvasë në zonat e kycjes me muraturën përreth.

Dritaret me formë harkore në katin e sipërm janë kryesisht të ruajtura, por elementet prej druri të kornizave dhe kanateve paraqesin amortizim të dukshëm dhe dëmtime nga ekspozimi ndaj kushteve atmosferike.

Oxhaqet, të pranishme në ambientet e banimit, ruhen në formë dhe volum, duke dëshmuar organizimin funksional tradicional të banesës. Megjithatë, në disa raste vërehet degradim i suvasë përreth dhe konsumim i elementeve të brendshme të vatrës së zjarrit.


Objekti është i rrethuar me avlli guri rreth 2 m të lartë, i cili paraqitet në gjendje të mirë strukturore, me dëmtime të kufizuara lokale. Territori përreth monumentit shfaq ndërhyrje të rastësishme bashkëkohore dhe elemente ndihmëse të përkohshme, të cilat ndikojnë negativisht në perceptimin vizual të monumentit, por jo drejtpërdrejt në stabilitetin e tij ndërtimor.

Në tërësi, Banesa Shtetërore (ish-spitali i qytetit) ruan në masë të konsiderueshme integritetin arkitektonik, tipologjik dhe konstruktiv, duke përbërë një shembull të rëndësishëm të arkitekturës vernakulare të Çamërisë. Megjithëse objektit nuk i kanoset aktualisht rrezik i menjëhershëm

shembjeje, gjendja e disa elementeve kërkon ndërhyrje konservuese të kontrolluara për të parandaluar degradimin e mëtejshëm dhe për të garantuar ruajtjen afatgjatë të vlerave të tij historike dhe arkitektonike.

C. BANESA SHTETËRORE (ISH E ALUSH TAKËS)

Banesa monument kulture, e ndërtuar në fund të shekullit XIX në qendër të lagjes Shehat të Konispolit, shpallur monument kulture e kategorise I, Nr. 266/1. Datë . 16.02.1979, paraqet aktualisht një gjendje të avancuar amortizimi, të vlerësuar rreth 75%, e shkaktuar nga shembjet e pjesshme pas viteve 1990, braktisja funksionale e një pjese të volumit dhe mungesa e ndërhyrjeve sistematike restauruese. Objekti ka qenë fillimisht një banesë e madhe fshatare me zhvillim në tre kate dhe organizim kompleks hapësinor, por sot ruhet vetëm pjesa lindore e tij, e cila është edhe e vetmja zonë funksionale.





Muret mbajtëse të banesës janë ndërtuar me muraturë guri të lidhur me llaç gëlqeror dhe paraqesin një gjendje heterogjene ruajtjeje. Në pjesën lindore, muratura ruan integritet relativ strukturor, megjithëse vërehen degradime të shtresës së suvasë, humbje të materialit lidhës dhe ekspozim i gurëve, veçanërisht në fasadat e ekspozuara ndaj lagështisë dhe faktorëve atmosferikë.

Në anët perëndimore dhe qendrore, të cilat janë shembur pas viteve 1990, mbeten vetëm fragmente murature dhe mure ndarëse të pjesshme, duke dëshmuar për humbjen e volumit fillestar të banesës. Këto zona janë tërësisht të ekspozuara dhe vazhdojnë të degradohen për shkak të mungesës së mbrojtjes strukturore.

Qoshet e ruajtura të objektit, të ndërtuara me gurë të gdhendur, janë ende të lexueshme dhe përbëjnë elementë të rëndësishëm për identifikimin e fazave ndërtimore dhe tipologjike të banesës. Çatia e pjesës lindore të banesës është e ndërtuar me kapriata druri dhe e mbuluar me tjegulla, duke ruajtur në pjesën më të madhe funksionin e saj mbrojtës. Megjithatë, vërehen zhvendosje të pjesshme të tjegullave, amortizim i elementeve drusore dhe ndërhyrje të kufizuara jo origjinale, të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e pamjes fillestare të mbulesës.

Në pjesët e shembura të objektit, çatia mungon tërësisht, çka ka përshpejtuar degradimin e mureve dhe elementeve të mbetura konstruktive.

DysHEMEJA e katit përdhe, aty ku objekti ruhet, është e shtruar me pllaka guri dhe paraqet shenja konsumimi të sipërfaqes, por ruan karakterin tradicional dhe funksionalitetin bazë. Katet e sipërme, të ndërtuara me konstruksion druri dhe dërrasa, janë pjesërisht të ruajtura vetëm në pjesën lindore të banesës; në zonat e tjera ato janë shembur plotësisht, duke humbur lidhjen vertikale dhe organizimin origjinal të hapësirave.

TAVANET dhe shkallaret prej druri që lidhin katet, në pjesën e ruajtur të objektit, paraqiten në gjendje të amortizuar, me dëmtime sipërfaqësore dhe shenja plakjeje të materialit, por pa rrezik të menjëhershëm shembjeje.

Banesa ka pasur fillimisht dy porta të jashtme me qemer guri, të cilat përbënin elemente të rëndësishme për kompozimin arkitektonik dhe kontrollin e hyrjes në oborr. Aktualisht, vetëm një pjesë e këtyre elementeve është e ruajtur, ndërsa qemerët në zonat e shembura janë fragmentuar ose kanë humbur funksionin e tyre konstruktiv.

Hapjet e shumta të fasadave, të kornizuara me gurë të gdhendur, janë ende të identifikueshme në pjesën lindore, megjithëse dritaret dhe elementet prej druri të tyre janë në gjendje të amortizuar ose të munguar, duke lënë ambientet të ekspozuara ndaj faktorëve atmosferikë.

Oxhaqet, të cilat ishin pjesë integrale e organizimit funksional të banesës dhe të odave të saj, janë të ruajtura pjesërisht vetëm në zonën lindore. Ato paraqesin degradim të suvasë përreth, konsumim të materialeve ndërtimore dhe dëmtime të vatrave të zjarrit, por mbeten të lexueshme si element tipologjik.

Banesa është e rrethuar me mure rrethues guri, të cilët ruhen pjesërisht dhe paraqiten në gjendje mesatare. Në anën veriore, ku ndodhen dy portat e oborrit dhe zapanaja, rrethimi është më i lexueshëm, ndërsa në pjesët e tjera vërehen shembje dhe ndërprerje të vazhdueshme të murit rrethues.

Zapanaja, e ndërtuar si objekt ndihmës për strehim dhe pritje, paraqet gjithashtu një gjendje të amortizuar, me dëmtime strukturore dhe humbje të mbulesës në disa zona, duke reflektuar të njëjtat problematika ruajtjeje si objekti kryesor.

Nga analiza morfologjike dhe krahasimi i volumetrisë, evidentohen qartë ndërhyrje ndërtimore të mëvonshme në pjesën e pasme të banesës, të cilat përfaqësojnë një fazë të dytë zhvillimi krahas bërthamës fillestare të objektit. Kjo shtesë dallon si në organizimin hapësinor, ashtu edhe në trajtimin konstruktiv dhe raportin me volumin origjinal.

Në gjendjen aktuale, banesa përfaqëson një monument kulture me vlera të larta tipologjike dhe historike, por me humbje të konsiderueshme të volumit dhe integritetit të saj ndërtimor. Ruajtja vetëm e pjesës lindore e bën të domosdoshme ndërhyrjen urgjente konservuese dhe stabilizuese, me qëllim ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe mbrojtjen e elementeve të mbetura autentike.

D. BANESA E HAME TAKOS





Banesa monument kulture, e vendosur në lagjen Shehat të Konispolit dhe e datuar në fillimet e shekullit XX, shpallur monument kulture e kategoriaisë së parë, Nr. 266/1. Datë . 16.02.1979, paraqet aktualisht një gjendje ruajtjeje të ndërmjetme, me dëmtime të dukshme të disa elementeve arkitektonike dhe konstruktive, të shkaktuara kryesisht nga ndërhyrjet e pas viteve 1990, amortizimi natyror i materialeve dhe mungesa e një mirëmbajtjeje të kontrolluar.

Objekti është ndërtuar me muraturë guri të lidhur me llaç gëlqeror në lartësinë e tre kateve. Muret perimetrale ruajnë në përgjithësi qëndrueshmëri strukturore, por paraqesin çarje të dukshme sipërfaqësore, veçanërisht në zonat pranë hapjeve dhe në segmentet ku ndërhyrjet e mëvonshme kanë prishur vazhdimësinë konstruktive të murit.

Në fasadën e pasme dhe anësore vërehet degradim i suvasë, njolla të errëta biologjike, shenja lagështie dhe humbje lokale e materialit lidhës, duke ekspozuar gurët e muraturës. Qoshet e banesës dhe kornizat e dyer-dritareve, të ndërtuara me gurë të punuar, janë ende të lexueshme, por shfaqin konsumim dhe erozion të sipërfaqes.

Pas viteve 1990, në anën perëndimore të objektit është bashkangjitur një banesë e re nga pronarët, ndërhyrje kjo që ka dëmtuar rëndë një krah të zhvilluar të banesës historike. Si pasojë, forma origjinale e tipologjisë në zhvillim në dy krahë (formë U) është deformuar dhe një pjesë e rëndësishme e volumit fillestar është humbur ose është integruar në mënyrë të papërshtatshme me ndërtimin e ri. Kjo ndërhyrje ka ndikuar negativisht në leximin tipologjik të objektit, në simetrinë e fasadave dhe në integritetin arkitektonik të monumentit.

Çatia është e ndërtuar me konstruksion druri dhe e mbuluar me tjegulla. Nga vëzhgimi vizual rezulton se mbulesa e çatisë është pjesërisht e amortizuar, me tjegulla të zhvendosura dhe elemente drusore të konsumuara, çka favorizon infiltrimin e ujërave atmosferike.

Dyert dhe dritaret, të pajisura me harqe guri të punuar, përbëjnë një nga elementet më karakteristike arkitektonike të banesës. Aktualisht, këto elemente nuk janë në gjendje të mirë: kornizat prej druri janë të amortizuara, disa hapje janë pa kanate, ndërsa të tjera janë mbyllur në mënyrë të përkohshme ose të papërshtatshme.

Humbja ose degradimi i elementeve të drurit ka rritur ekspozimin e ambienteve të brendshme ndaj faktorëve atmosferikë dhe ka përshpejtuar procesin e amortizimit.

Banesa është e rrethuar me mur guri të çrregullt me trashësi rreth 35 cm dhe lartësi rreth 2 m, i lidhur me llaç. Rrethimi paraqitet në gjendje të mirë strukturore, me dëmtime të kufizuara lokale. Në pjesën hyrëse të objektit vërehet një zonë e suvatuar rreth 15 m², e realizuar si ndërhyrje e mëvonshme, e cila ndryshon nga trajtimi origjinal i fasadës.

Në gjendjen aktuale, banesa ruan një pjesë të konsiderueshme të vlerave arkitektonike dhe tipologjike, por integriteti i saj është dëmtuar nga ndërhyrjet e pas viteve 1990 dhe nga amortizimi progresiv i materialeve. Objektit nuk i kanoset rrezik i menjëhershëm shembjeje, por gjendja e elementeve të drurit, e çatisë dhe e hapjeve kërkon ndërhyrje konservuese të kontrolluara për të parandaluar degradimin e mëtejshëm dhe për të ruajtur vlerat këtij monumenti.

E. BANESA E SHABAN XHEMALIUT

Banesa monument kulture e kategorisë së parë, shpallur Nr. 266/1. Datë . 16.02.1979, e ndodhur në lagjen Mesmëhallë, fshati Shalës, përfaqëson një shembull të rëndësishëm të arkitekturës vernakulare të gjysmës së dytë të shekullit XIX, me tipologji banese dy-katëshe me zhvillim në të dy krahët dhe me prani të elementeve mbrojtëse, si kulla me frëngji.





Megjithëse objekti vijon të jetë i banuar dhe në përdorim, analiza e gjendjes aktuale evidenton një shkallë të konsiderueshme tjetërzimi të imazhit arkitektonik, veçanërisht në pamjen ballore.

Fasada kryesore ka pësuar ndërhyrje të dukshme, të cilat kanë cenuar lexueshmërinë e kompozimit fillestar. Ndërhyrjet përfshijnë zëvendësimin e dritareve tradicionale prej druri me elementë alumini, modifikime në trajtimin sipërfaqësor të muraturës, si dhe ndërhyrje në elementët e hapjeve, duke ndryshuar raportet origjinale të boshllëqeve dhe karakterin estetik të fasadës. Këto veprime kanë sjellë një humbje të autenticitetit material dhe formal të pamjes kryesore, duke e distancuar objektin nga gjuha e tij arkitektonike historike.

Në kontrast me fasadën balllore, volumi i pasëm i banesës, i ndërtuar tërësisht në muraturë guri, paraqet një nivel më të lartë autenticiteti dhe ruan në mënyrë më të qartë tiparet arkitektonike dhe konstruktive të fazës origjinale të ndërtimit. Në këtë pjesë vërehen ende hapje me harqe guri të përpunuar, muraturë me gurë të papërpunuar të lidhur me llaç gëlqereje, si dhe raportet fillestare të volumit, të cilat dëshmojnë për teknikat tradicionale të ndërtimit dhe për organizimin funksional të banesës.

Nga pikëpamja konstruktive, muret mbajtëse prej guri me trashësi rreth 60 cm paraqiten në përgjithësi të qëndrueshme, megjithëse në disa zona vërehen çarje sipërfaqësore dhe shenja degradimi të llaçit lidhës, të shkaktuara nga lagështia, mosmirëmbajtja periodike dhe ndërhyrjet e pakontrolluara. Prania e brezave druri brenda muraturës, e evidentuar në disa ambiente, përbën një element të rëndësishëm të teknikës tradicionale, i cili kontribuon në stabilitetin strukturor të objektit.

Sistemi i mbulimit të çatisë është realizuar me tjegulla vendi, ndërsa pjesa e strehës, me një gjerësi rreth 1.20 m, është e mbuluar me rrasa guri, një zgjidhje tradicionale funksionale për mbrojtje nga kushtet atmosferike të ashpra. Megjithatë, në disa zona vërehen shenja amortizimi të elementeve drusore të konstruksionit të çatisë, si dhe dëmtime të pjesshme të mbulesës, që mund të çojnë në infiltrime uji dhe përkeqësim të mëtejshëm të gjendjes së objektit.

Në brendësi, dyshemetë prej dërrase të kateve të sipërme dhe pllakat e gurit të katit përdhe janë në gjendje mesatare, me konsumim të dukshëm sipërfaqësor, por ende të lexueshme si elementë origjinalë. Tavanet prej dërrase, sidomos në odën e miqve, ruajnë tipare autentike, megjithëse në disa ambiente shfaqen shenja lagështie, njolla dhe deformime lokale të materialit drusor. Oxhaqet, si elementë funksionalë dhe simbolikë të banesës tradicionale, janë pjesërisht të ruajtur, por disa prej tyre janë jashtë funksionit ose të modifikuar. Gjithsesi vihet re se edhe në brendësi ndërhyrjet kanë tjetërsuar elementët arkitektonike të banesës.

Në përfundim, objekti paraqet një kontrast të qartë ndërmjet pjesëve të tjetërzuara dhe atyre që ruajnë vlerat autentike arkitektonike dhe konstruktive. Ndërsa fasada kryesore ka humbur në masë të konsiderueshme karakterin e saj historik për shkak të ndërhyrjeve të vona, volumi i pasëm në muraturë guri mbetet një dëshmi e rëndësishme e arkitekturës vernakulare të zonës dhe përbën bazën kryesore për çdo ndërhyrje të ardhshme restauruese me synim rikthimin dhe ruajtjen e identitetit origjinal të monumentit.

6. Foto nga inspektimi në terren



7. Hapat e radhës

Procesi i punës do të vijojë në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar, duke ndjekur një qasje territoriale të zgjeruar që synon jo vetëm identifikimin e gjendjes aktuale të monumenteve ekzistuese, por edhe vlerësimin e banesave dhe strukturave të tjera me potencial për t'u konsideruar si pjesë e trashëgimisë kulturore. Inspektimi në terren do të fokusohet gjithashtu në elemente përbërëse të banesës fshatare, si oborret ekonomike ndihmëse, furrat tradicionale, mullinjtë dhe

struktura të tjera funksionale, të cilat kontribuojnë ndjeshëm në karakterin historik dhe identitetin e qendrave të banuara.

Në këtë kuadër, procesi synon identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e potencialeve të reja zhvillimore, kulturore dhe socio-ekonomike në zona të ndryshme rurale, duke ndërlidhur trashëgiminë e ndërtuar me peizazhin natyror, strukturën sociale dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm, turizëm kulturor dhe iniciativa lokale.

Në fazën e parë, fokusi do të jetë në zonën e Bregut, konkretisht në fshatrat Qeparo, Piqeras dhe Lukovë, ku do të analizohet marrëdhënia midis peizazhit, tipologjive të banimit, elementeve ndihmëse të ekonomisë shtëpiake dhe dinamikave sociale lokale. Ky vlerësim do të shërbejë si bazë për identifikimin e modeleve të ndërhyrjes që ruajnë autenticitetin dhe forcojnë zhvillimin lokal.

Në vijim, vëmendja do të zgjerohet drejt zonës së Bregut të Sipërm, duke përfshirë fshatra si Sasaj, Fterrë, Çorraj dhe vendbanime të tjera përreth. Këto zona përfaqësojnë një trashëgimi të pasur kulturore dhe një kontekst territorial me sfida të dukshme, por edhe me potenciale të rëndësishme për rigjallërim rural. Në këtë fazë, puna do të përqendrohet në kuptimin e nevojave të komuniteteve lokale, në vlerësimin e banesave dhe strukturave tradicionale me potencial zhvillimi dhe në identifikimin e ndërhyrjeve që respektojnë identitetin e zonës dhe nxisin ekonominë vendore.

Në një fazë të mëtejshme, procesi do të shtrihet në territorin e Zagorisë, duke përfshirë fshatra si Sheper, Dhrovian dhe zona të tjera përreth, me synimin për të ndërtuar një kuadër krahasues dhe të integruar në shkallë më të gjerë. Kjo qasje do të mundësojë hartëzimin e plotë të potencialeve territoriale, lidhjen e zonave me karakteristika të ndryshme, por me sfida dhe mundësi të përbashkëta, si dhe vendosjen e bazave për strategji afatgjata zhvillimi që ndërthurin trashëgiminë kulturore, mjedisin dhe komunitetin lokal.

Punoi:

Klesta Qirici

Saimir Kristo

Andi Papastefani

Koi Barbullushi